

UDHËZIM
Nr. 626, datë 27.8.2018

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE
MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”,
TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuara.
 2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të vendimit dhe 11.070 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.
 3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet akorduar për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 4. Udhëzimi nr. 366, datë 21.9.2017, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shfuqizohet.
- Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2018.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**